



## **FORUMI BARLETI GAL**

### ***AGORA E MIRËQEVERISJES DHE ZBATIMIT TË LIGJIT***

#### **KONCEPTIMI**

Forumi Barleti GAL (Governance and Law) është një Forum informativ, interaktiv dhe konsultativ që synon të afrojë studentët dhe pedagogët me qeverisjen dhe zbatimin e Ligjit. Ky Forum synon të kthehet në një Platformë promovimi për praktikat më të mira të Qeverisjes dhe Sundimit të Ligjit si dhe diskutimi për Ligjet apo edhe Nismat e reja të qeverisjes. Nevoja për një qeverisje të mirë, që shkon paralelisht me nevojën për zbatimin e ligjit, është një problem sa politik e social, aq edhe një bosht rreth së cilës endet pëlhura e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të shoqërisë shqiptare.

Duke ju referuar indiferencës në rritje të të rinjve shqiptarë ndaj politikës në përgjithësi, si dhe një lloj “rebelimi” ndaj zbatimit të ligjit në fusha të caktuara, mendojmë që të krijojmë një Forum aktiv ku do të vihen përballë njëri tjetrit: Qeverisja me politikën e saj nga njëra anë, dhe studentët me perceptimet e tyre nga ana tjetër. Ky ballafaqim do t’i japë zë nevojës për një pjesëmarrje aktive të të rinjve në vendimmarrje, si dhe do të rrisë interesin e tyre për t’u informuar, për të mësuar dhe për të menduar mbi një qeverisje më të mirë që fokusohet dhe shikon nga interesat e rinisë, si dhe një ndërgjegjësim më të madh mbi nevojën e zbatimit të ligjit nga kushdo dhe kurdoherë!

Ky Forum synon gjithashtu t’i bëjë studentët dhe pedagogët pjesë të një demokracie pjesëmarrëse dhe funksionale duke siguruar një formë “agore” universitare, ku përfaqësues të lartë të Qeverisë dhe Institucioneve ligjzbatuese do të diskutojnë rreth problemeve të qeverisjes dhe nevojës për sundim të ligjit.

## **QËLLIMET KRYESORE:**

Nëpërmjet diskutimeve dhe dialogut të drejtpërdrejtë dhe të hapur me titullarë të ministrive, me kryetarë të njësive të pushtetit vendor, me titullarë të institucioneve kryesore ligjore dhe drejtues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin në vendin tonë, ne synojmë:

- Vendosjen e dialogut të strukturuar interaktiv ndërmjet të rinjve dhe titullarëve të ministrive (Ministra) dhe titullarëve të pushtetit vendor (Kryetarë Bashkish). Ky dialog do na shërbejë për të rritur interesin e të rinjve dhe nxitjen e mendimit të kualifikuar të pedagogëve me synim një qeverisje sa më të mirë.
- Krijimin e një dialogu bashkëpunues me titullarë të institucioneve ligjzbatuese. Një diskutim dhe debat mbi zbatueshmërinë e ligjeve do na shërbejë për të krijuar një kulturë të fortë në zbatim të ligjit tek të rinjtë, por edhe për t'i dhënë zë mendimeve të tyre në lidhje me këtë zbatueshmëri.
- Nxitjen e interesit të organeve të qeverisjes dhe atyre të zbatimit të ligjit për të marrë në konsideratë jo vetëm mendimet e të rinjve, por edhe mendimet e kualifikuara të stafit akademik universitar.

## **ORGANIZIMI**

Ky forum do të realizohet çdo muaj (gjatë gjithë vitit akademik) me një fokus të kësaj natyre:

- 3 ministra (titullarë të ministrive)
- 3 titullarë të institucioneve kryesore ligjzbatuese
- 2 kryebashkiakë
- 2 drejtues të organizatave ndërkombëtare që kryejnë aktivitet në vendin tonë.

Radha e të ftuarve do të jetë e alternuar.

Në muajin shtator të vitit pasardhës do të organizohet një Konferencë përmbyllëse në lidhje me konkluzionet e arritura nga zhvillimi mujor i debateve mbi Mirëqeverisjen dhe Zbatimin e Ligjit.

Forumi është permanent.

**Përgjegjësit:**

Forumi organizohet në bashkëpunim nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike e Komunikimit dhe Departamenti i Drejtësisë.

**Koha e zhvillimit:**

Çdo mes muaji nga data 10 deri në datën 20.

Prof Ass Dr Zamira Cavo

Kryetare e Bordit të Besuarve

E-mail : [z.cavo@umb.edu.al](mailto:z.cavo@umb.edu.al)